



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:165341

Datë: 18.12.2023

Numri i dokumentit: 05082071

P.nr.2547/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.K., për shkak të veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.2976/2019 të datës 29.07.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 14.12.2023, të hapur për publikun, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Nebahate Salihu dhe i akuzuari A.K. me mbrojtësin e tij të sipas autorizimit avokatin V.B., me datë 15.12.2023 publikisht shpalli, ndërsa me datë 18.12.2023 me shkrim e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari A.K., nga babai B., nëna Sh., e gjinisë J., i lindur me datë ...., në P....., me vendbanim në ....., rruga “....., Objekti Banesor “.....”, ....., nr. ...., .., i martuar, babai një fëmije, i punësuar si agjent tregtar, ka të përfunduar shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal .....

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 16.06.2019, rreth orës 04:50 minuta, në rrugën Fushë Kosovë – Prishtinë, te rreth rrotullimi i ....., në afërsi të shkollës së mesme ekonomike, në lagjen Emshir në Prishtinë, i akuzuari derisa ka qenë nën ndikimin e alkoolit e ka drejtuar automjetin e tipit “....”, ngjyrë të kuqe, me tabela të regjistrimit ....., e ka shkelur Ligjin mbi trafikun publik dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke vepruar në kundërshtim me Ligjin mbi komunikacionin rrugor dhe me pjesën e përparme e ka goditur në pjesën e majtë të anës së pasme automjetin e

tipit “...”, me ngjyrë të bardhë, me tabela të regjistrimit ....., të cilin ka qenë duke e drejtuar e dëmtuara ....., e cila bashkë me pasagjerin e automjetit K. H. kanë pësuar dëmtime të lehta trupore,

-Me këtë ka kryer veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së dhe neneve 242 e 364 të KPP-ës, të akuzuarin:

### E GJYKON

I. Me dënim me gjobë në shumën prej 700 (shtatëqind) euro, të cilin dënim obligohet t’u paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje t’u paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t’i caktohet një ditë burgim.

III. Të dëmtuarit E. H. dhe K. H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

IV. Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro), si dhe në emër të ligjit për kompensimin e viktimave shumën prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### A R S Y E T I M

#### -Rrjedha e procedurës penale-

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 01.08.2019, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.2976/2019 të datës 29.07.2019, kundër të akuzuarit A.K., për shkak të veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Me datë 14.12.2023, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ish-in prezent prokurorja e shtetit Nebahate Salihu dhe i akuzuari A.K. me mbrojtësin e tij të sipas autorizimit avokatin V. B.. Në këtë seancë prokurorja e shtetit ka lexuar aktakuzën lëndore, me

ç ‘rast i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç ‘rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit.

#### -Vlerësimi i pranimit të fajësisë-

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, e po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

#### -Gjendja faktike e vërtetuar-

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

#### -Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit-

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale,

kërkim faljen e singertë në drejtim të të dëmtuarve, gjithashtu gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale ku i njëjtit asnjëherë më parë nuk kishte rënë ndesh me ligjin, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë. Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit E. H. dhe K. H. i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko-civil.

-Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së. Ndërsa, për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.2547/19 , me datë 18.12.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Dibran Jusufi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.